



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjore

**RELACION PER DEKRETIN E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES
PER KTHIMIN E LIGJIT NR. 9047 DATE 7.4.2003 "PER
SHERBIMIN USHTARAK NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE"**

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjore ne mbledhjen e tij te dates 2.6.2003 morri ne shqyrtim Dekretin e Presidentit te Republikes me ane te te cilit, ne baze te kompetences kushtetuese, kthen per rishqyrtim ne Kuvend ligjin nr. 9047 date 7.4.2003 "Per sherbimin ushtarak ne Republiken e Shqiperise". Komisioni i shqyrtoi argumentat e kthimit te ketij ligjit ne prani te perfaqesuesve te Presidentit, te Ministrit te Mbrojtjes dhe stafit te tij *dhe me shumice votash vendosi t'i propozoje seances plenare mosmiratimin e dekretit te Presidentit te Republikes.*

Ne keto kushte kur vendimi i shumices se Komisionit eshte per mosmiratimin e ketij dekreti, pra per rrezimin e tij, seanca plenare duhet te vendose, sipas nenin 85 pika 2 te Kushtetutes, me shumicen e te gjithe anetareve te Kuvendit (shumice absolute – te pakten 71 vota pro rrezimit te dekretit te Presidentit)

Ne Komision u paraqit edhe mendimi i pakices sipas se cilit argumentet e Presidentit per kthim ishin te drejta, pasi kemi te bejme me shkelje kushtetuese dhe konkretisht te percaktimeve qe bejne nenet 18 dhe 166 te Kushtetutes.

Kryetari

Spartak BRASHO



REPUBLICA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Mbrojtjes

Tirane me, 03.06.2003

RELACION

**PER DEKRETIN E PRESIDENTIT, "PER KTHIMIN E LIGJIT NR.
9047, DATE 07 .04. 2003 "PER SHERBIMIN USHTARAK NE
REPUBLIKEN E SHQIPERISE ".**

Komisioni i Mbrojtjes ne mbledhjen e datës 02.06.2003 morri ne shqyrtim Dekretin e Presidentit te Republikes se Shqiperise "Per kthimin e ligjit nr. 9047, date 7.04.2003 "Për sherbimin ushtarak ne Republikën e Shqiperise"".

Komisioni pas diskutimesh te shumta mbi argumentat e sjelle nga institucioni i Presidentit lidhur me aresyet e kthimit te ketij ligji, ne prani edhe te Ministrit te Mbrojtjes dhe specialisteve te Ministrise se Mbrojtjes u shpreh me shumice votash kunder miratimit te Dekretit "Per kthimin e ligjit nr. 9047, date 7.04.2003 "Për sherbimin ushtarak ne Republikën e Shqiperise" ne seance plenare. (Raporti i votimit ne komision ishte 6 vota kunder miratimit te dekretit dhe dy vota pro miratimit te dekretit).
Per voten kunder deputetet do të shprehen edhe në seancë plenare.

KRYETARI

Dashamir SHEHI

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste dhe Grupi Parlamentar i PD propozon në seancë plenare pranimin e Dekretit të Presidentit të Republikës për Ligjin "Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë", duke reflektuar vërejtjet e tij si më poshtë :

Neni 43, shfuqizohet.

Neni 10, pika 1, riformulohet :



"1. Kohëzgjatja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ është 12 muaj. Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollat e larta universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, në përshtatje me diplomimin e tyre dhe sipas përcaktimeve që bën Ministri i Mbrojtjes kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ për një periudhë 3 mujore".

KRYETARI I GRUPIT PDSH

KRYETARI I GRUPIT TË PSSH

Bamir TOPI

Gramoz RUCI



6- Për pagimin i kësaj vart të
lepeve me shumicë
7 -> 1 muaj
enë po të jeto 1 muaj

Spartak Kruja
